



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 1/2025

I Mbajtur në takimin I-rë të rregullt të KK-së me datën 30.12.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e I-rë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Betimi i Anëtarëve të rinjë të cilët janë zëvendësuar;
5. Propozim – Vendim për Orarin e mbledhjeve të Kuvendit të komunës për Vitin 2026;
6. Propozim – Vendim për Themelimin e Hartimit të Planit të Kuvendit të Komunës për Vitin 2026;
7. Propozim – Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
8. Propozim – Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete;
9. Propozim – Vendim për anulimin e vendimit 01.Nr.78 i datës 31.07.2025
10. Propozim – Vendim për publikimin e listës së pronave për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026;
11. Pyetje dhe kërkesa dhe
12. Të ndryshme.

Kryesuesi pasi e lexoi rendin e ditës, i ftoj për të bërë betimin anëtarët e rinjë të Kuvendit të Komunës.

Pas përfundimit të betimit Kryesuesi i falënderoi dhe ju uroj suksese në këtë legjislaturë të kuvendit dhe më pas vazhdoi me rendin e ditës ku sa i përket pikës së parë lidhur me pjesëmarrjen nuk kam ndonjë paralajmërim për mungesë, më pas edhe sa i përket pikës së dytë rreth rendit të ditës, nuk pati të interesuar për diskutim.

Sa i përket pikës së 3-të rreth procesverbalit nuk pati vërejtje dhe i njëjti kaloi me 27 vota për.

Kryesuesi theksoi që pikën e 4-të e kemi kryer në fillim.

Sa i përket pikës së 5-të e kemi të paraqitur në propozim një orar të mbledhjeve dhe i njëjti nuk do të thotë që nuk mund të ndryshohet, mirëpo është procedurë që çdo fundvit të kemi orarin për mbledhje për vitin që po hyjmë, a ka dikush për të shtuar rreth këtij propozimi, pasi nuk pati i njëjti kaloi me 41 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6-të the theksoi që është procedurë ligjore që kuvendi përpos orarit të mbledhjeve të ketë edhe Planin e Punës së Kuvendit për vitin pasues, andaj fillimisht duhet të kemi një komision që komisioni të punoj planin, e më pas ta sjellin në kuvend këtë plan.

Nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni, nëse nuk ka, ju ftoj nga secili subjekt politik të paraqitni emrat për anëtarë të këtij komisioni:

Emrat e propozuar për këtë komision janë:

- Elbasan Osmani – PDK
- Arbnor Murseli – LVV
- Bashkim Haliti – LDK
- Izet Rushti – AAK
- Dorentina Azizi – Ne mundemi.

Këta emra u hodhën në votim dhe kjo pikë kaloi me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi theksoi që tani duhet t'i propozojmë emrat për Komitetin obligativ për Politikë dhe Financa dhe në bazë të numrit të banorëve të qytetit caktohet edhe numri i ulëseve në kuvend të komunës ku ne i kemi 41, dhe në bazë të kësaj të dy komitetet obligative duhet t'i kenë nga 9 anëtarë.

Në Komitetin për Politikë dhe Financa ex-officio kryesuesi i kuvendit është edhe Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj ju ftoj që të bëni propozimet nga subjektet.

Nga PDK-ja u propozuan: Arian Imeri, Ejup Delolli, Lumnije Morina dhe Vanesa Sadiku Topoojani.

Nga LVV u propozua: Yllkë Neziri Hyseni, Brahim Osmani.

Nga LDK u propozua: Visar Azemi

Nga Ne Mundemi: Fisnik Nazifi

Ky vendim kaloi me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Pika e 8-të themelimi i Komitetit për Komunitete, po ashtu edhe ky komitet është obligativ dhe duhet t'i ket 9 anëtar prej te cilëve 5 janë nga komunitetet dhe 4 duhet të jenë nga kuvendi i komunës.

Dhe emrat e propozuar janë:

Nga PDK: Flora Abdullahu dhe Erëza Hashani

Nga LVV: Xhevat Sallahu dhe

nga LDK Besnik Salihu

Ndërsa pjesë e këtij komiteti do të jenë edhe pjesëtarët nga komunitetet tjera pakicë në qytet:

Xhemajl Jashari – Rom

Osman Emini – Ashkali

Bislim Kopili- Exhiptian

Silvana Macak – Serbe

Zenel Elami – Goran.

Këta emra u votuan me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Arbër Bytyqi i cili pasi përshëndeti të pranishmit ju uroj mandatin e ri dhe sa i përket kësaj pike ka të bëjë me anulimin e vendimit për Emërtim të Rrugëve dhe për shkak të procedurave ligjore të anulohet pasi i njëjti është shpallur i paligjshëm nga MAPL-ja, do ta anulojmë dhe të rifillojmë procedurën për këtë pikë.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush diçka për të shtuar për këtë pikë dhe pasi nuk pati e hodhi në votim dhe i njëjti kaloi me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi ia kaloi fjalën Drejtores së re të Kadastrit Festina Sadiku për ta paraqitur pikën e saj për publikimin e listës së pronave për dhënien në shfrytëzim për Vitin 2026, e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që ky është një obligim ligjor - publikimi i listës për pronat 2026, sa i përket listës ka një ndryshim të vogël tek parcelat në Komogllavë 3601 dhe 3602 janë shpronësuar dhe të njëjtave u vendoset një numër i ri 30613-3 dhe kemi dy parcela të reja që i shtohen listës të cilat janë në Mirash dhe ato janë: 2060-0 dhe 2055-0.

Kryesuesi pyeti kush është për miratimin e kësaj liste, për ishin 34 vota, abstenim 7 dhe 0 kundër.

Sa i përket pikës në të ndryshme pyetje dhe kërkesa nuk pati të interesuar, atëherë me kaq e mbyllim këtë mbledhje dhe meqenëse jemi në fund vit Urime Viti i Ri.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

